



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVË
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA

Pranuar - Primihera Më/Dana 01.07.2024 vit/gj			
Nr. i organit Org. broj	Numri/Broj	Shtojcë Prillog	Vlera Vlerësoje
02	035/02	-	912



Komuna e Vitisë
Opština Vitina
Municipality Viti/na

Kuvendi i Komunës së Vitisë në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d dhe neni 40, paragrafi 40.2, pika d të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008), neni 35, paragrafi 35.2, pika d të Statutit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/491, të datës 21.04.2011, Kuvendi i Komunës së Vitisë në mbledhjen e mbajtur më datën 28.06.2024, miraton këtë:

V E N D I M

për themelimin e grupit punues për hartimin e planit vjetor të punës së Kuvendit të Komunës së Vitisë për vitin 2025

Neni 1

Me këtë vendim Kuvendi Komunal i Vitisë miraton vendimin për themelimin e grupit punues për hartimin e planit vjetor të punës së Kuvendit Komunal të Vitisë për vitin 2025.

Komisioni përbëhet nga këta anëtar:

1. Bekim Azizi, kryesues i kuvendit komunal;
2. Valentina Mehmeti, GP i LDK-së;
3. Majlinda Shabani GP i VV-së;
4. Anisë Zejnullahu GP i PDK-së;
5. Reshat Azizi, këshilltar komunal nga AAK-ja;
6. Fatlum Demiri, sekretaria e kuvendit;
7. Adnan Ramadani, përfaqësuese nga shoqëria civile.

Neni 2

Grupi punues, konform nenit 1 të këtij vendimi, në konsultim me kryetarin e komunës, drejtorët e drejtorive komunale, subjektet politike të përfaqësuar në kuvend dhe shoqërinë civile harton draftin e Planit të Punës së Kuvendit të Komunës së Vitisë për vitin kalendarik 2024 dhe të njëjtin e paraqet para kuvendit të komunës për miratim.

Neni 3

Plani vjetor i punës së Kuvendit duhet të përmbaj objektivat dhe qëllimet e kuvendit, aktivitetet e planifikuara të kuvendit dhe komiteteve obligative dhe funksionale të kuvendit, afatet e përmbushjes dhe realizimin e aktiviteteve të parapara.

Neni 4

Plani i punës së kuvendit mund të ndryshohet dhe plotësohet nga ana e kuvendit sa herë që kjo të jetë e nevojshme.

Neni 5

Për zbatimin e këtij propozim vendimi kujdeset Kryesuesi i Kuvendit Komunal të Vitisë.

Neni 6

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrim të Pushtetit Lokal, në kuptim të nenit 81 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008), neni 8, lidhur me neni 9 të Rregullores Nr.10/2019 për procedurat e hartimi dhe publikimi të akteve të komunave dhe pas publikimit në web faqen e Komunës së Vitisë.

Dorëzohet:

1. Kryesuesit të Kuvendit;
2. Anëtarëve të grupit punues; dhe
3. Arkivit.

KRYESUESI I KUVENDIT
Bekim Azizi